



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datën **26.04.2024**, Nr. **76** Regj.Themeltar, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurës **Luiza Mandi**, akuzuar për veprën penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, me vendimin Nr. **317**, datë 13.06.2024 vendosi:
 1. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Luiza Mandi**, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, dhe bazuar në nenet 49, 248 të Kodit Penal, dënimin e saj me 1(një) vit burgim.
 2. Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës **Luiza Mandi** i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe përfundimisht dënohet me 8(tetë) muaj burgim.
 3. Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi, të formës së prerë, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
 4. Bazuar në nenin 35 paragrafi 2 të Kodit Penal, heqjen e së drejtës së të pandehurës **Luiza Mandi** për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5(pesë) vjet.
 5. Shpenzimet proceduriale, ato gjatë hetimit të çështjes në vlerën 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë si dhe ato të gjykimit, sipas formularit bashkëngjitur këtij vendimi, të paguhen nga e pandehura Luiza Mandi.

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 13.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar